

Mr. Predrag M. Lutovac

Tumbarice

Fortifikatë nga antika e vonë dhe krishterimii hershëm

Muzeu Polim Berane, polimskimuzej@t-com.me

Abstrakti: Në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë (projekti IPA), Muzeu i Polimles në Berane (mnc. Polimski muzej u Beranama) ndërmori gërmime arkeologjike sistematike në fortifikatën Tumbarice që ndodhet në fshatin D. Ržanici afër Beranës. S'ka dyshim që bëhet fjalë për një nga fortifikatat më të mëdha të regjistruara dhe pjesërisht të eksploruara në hapësirën e Polimles malazeze. Është ndërtuar në fund të shekullit II ose në fillim të shekullit III pas Krishtit. E pushtuar, rrënuar e më pas e ndërtuar dhe rindërtuar, mbijeton deri në shekullin e shtatë ose në fillim të shekullit të tetë të erës sonë. Në Tumbarice u gërmuan hapësira e akropolit dhe e bedenave mbrojtëse juglindore, me kulla dhe kalime të lëna. Në akropol u zbuluan mbetjet arkitekturore të kishës dhe kapelës veriore, të punuara në dy faza ndërtimi, si dhe mbetjet arkitekturore të pallatit të klerit. Mbi bazën e shtresave stratigrafike dhe të një morie materiale të luajtshe arkeologjike, dallohen qartë të gjitha fazat e jetës shumëshekullore të kësaj fortifikate. Gjatë punimeve, gërmimet janë bërë duke vendosur një rrjet katrorë, me katrorë 4 x 4 metra, e cila mundësoi vëzhgimin e qartë të shtresave stratigrafike përgjatë mbetjeve të zbuluara arkitekturore dhe ndarjen e materialit lëvizës sipas shtresave të përcaktuara stratigrafike. Mënyra e ndërtimit të fortifikatës dhe moria e sendeve të gjetura për përdorim të përditshëm, stolive, pjesëve të veshjeve dhe armëve janë një pikënisje e mirë për përcaktimin e qartë kronologjik të fortifikatave të tjera në Polimle.

Fjalët kyçe: Fortifikata paleokristiane, kisha, monedhat, stolitë dhe armët.

Tumbarice ndodhet në komunën e Beranës, më saktë, në skajin jugor të luginës së gjerë të Beranës, në fshatin Donja Ržanica (Fig. 1). Për këtë fortifikatë pothuajse s'ka të dhëna të shkruara dhe për herë të parë është përmendur nga R. J. Veshoviq në përshkrimin e fshatit në Donji Vasojevići (Vešović, 1935: 167). Muzeu i Polimles në Berane ndërmori gërmimet arkeologjike sondazhuese në vitin 2008, kur u eksploruan

një kullë gjysmërrethore në këndin jugor të fortifikatës dhe mbetjet e një objekti të madh që ndodhej në lindje të portës. Atëherë u zbuluan drejtimi i shtrirjes së bedenave në anën juglindore, kulla e madhe drejtkëndëshe dhe drejtimi i shtrirjes së bedenave në anën jugperëndimore. Të gjitha muret e zbuluara të fortifikatës dhe objektet e detektuara u xhiruan në mënyrë teknike. Gërmimet arkeologjike sistematike në pjesën juglindore të fortifikatës u ndërmorën në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë (projekti IPA).¹

Fortifikata është ndërtuar në një zonë të lartë shkëmbore, pothuajse të paarrtshme, në rrëzë të kodrës Zarugja (mne. Zaruda) dhe në hyrje të kanionit të lumit Kaludarska, në lartësinë mbidetare 796 metra. Zona e lartë shkëmbore është me formë elipsoide dhe ka orientim juglindje-veriperëndim. Faqet i ka të rrëpirëta dhe vështirë të depërtueshme, prandaj mund të kalohen vetëm nga ana lindore, ku bashkohen të gjitha rrugët e fshatrave fqinje: Donja Ržanica, Rovac dhe Aluga. Afër Tumbaricës kalonte një rrugë e vjetër mesjetare, e cila nga Polimla, nëpër malin e Mokrës (mne. Mokra) dhe qafa e Rugovës, të shpinte në Metohi. Gjatë ndërtimit të fortifikatave, vëmendje e veçantë u kushtua përcaktimit të anës jugore me qasje më të lehtë, ku ndodhej hyrja anësore - porta e vogël. Në këtë anë, poshtë kodrës me bedenë, u hoqën shkëmbinjtë dhe u formua një llogore mbrojtëse që shtrihet në juglindje, me gjerësi 15 m dhe gjatësi rreth 50 m. Qasja e llogores bëhej

¹ Gërmimet i drejtoi Mr. Predrag Lutovac - arkeolog; skuadra profesionale: Milija Pantović - konservues, Slobodan Obradović - dokumentarist, Vlado Lutovac - student i arkeologjisë.

nga skaji juglindor, përmes një kalimi të zgjeruar nëpër shkrepë e malit. Në jugperëndim, llogorja mbrohet nga një kreshtë shkëmbore, kurse ana verilindore e saj zbret rrëpirët në kanionit e lumit Kaludarska. Thepa shkëmbore në anën juglindore mund të ishte vija e parë e mbrojtjes së fortifikatës. Në skajin veriperëndimor të kësaj llogore mbrojtëse ngrihet një kodër mbi të cilën janë ndërtuar dy bedena mbrojtëse, pothuajse paralele, me një hyrje të vogël në fortifikatë. Mund të supozojmë se porta kryesore ndodhej ulët, në anën jugperëndimore, pikërisht pranë “Shpellës së Marës” (mne. Marina pećine) mbi të cilën u zbuluan mbetjet e një kulle tjetër gjysmërrethore.

ARKITEKTURA MBROJTËSE

Në bazë të lidhjeve të dukshme të bedenave në anën juglindore, mund të veçojmë dy faza të ndërtimit:

Në fazën e parë të ndërtimit, duke ndjekur konfigurimin e terrenit, u ngritën bedenat në anët juglindore dhe jugperëndimore, e ndoshta edhe në atë veriperëndimore (Fig. 3/1). Drejtimi i mureve në anën veriperëndimore u konfirmua pjesërisht, derisa në anën verilindore as që ekzistonte, sepse kjo anë është e pakalueshme dhe zbret rrëpirët në kanionin e lumit Kaludarska. Bedenat janë me gjerësi 1,40 m, të punuara me teknikën *opus incertum* (Basler, 1972: 30-31), nga blloqe guri të papërpunuar dhe të gdhendur, të stivuar në rreshta horizontale mjaft të rregullt të lidhur me llaç gëlqereje me agregat të madh lumi.

Një kullë gjysmërrethore (Fig. 3/2), me diametër 6,00 m, u ngrit në vendin ku bashkohen bedeni juglindor me atë jugperëndimor. Në pjesën e brendshme, në skajin lindor, gjendet kullorja e murit, me gjatësi 1,70 m, e cila mbron faqen e kalimit të dikurshëm për në akropol. Nga kjo kullë, në drejtim të veriperëndimit, shtrihen mbetjet e bedenit që thyhen dhe ndjekin drejtimin e rrëpirave, duke mbyllur të çarat dhe kalimet ndërmjet shkrepave malore. Bedeni u zbulua në një gjatësi prej rreth 65 metrash dhe përfundon në një kullë tjetër gjysmërrethore që u ndërtua në një shkëmb, mu mbi “Shpellën e Marës” (Fig. 3/3). Poshtë kullës, në vijë me Shpellën e Marës, ka një zgjerim të rrafshët, andaj mund të supozohet se aty ndodhej porta kryesore e fortifikatës.

Nga kulla jugore në drejtim të lindjes, bedeni shtrihet me gjatësi rreth 48 metra dhe përfundon në skajin e shkrepës së rrëpirët të kanionit të lumit Kaludarska. Mbjetet e një kulle të madhe drejtkëndëshe (Fig. 3/4), me përmasa të jashtme 9,45 x 4,15 m, u zbuluan në këtë beden, në distancë prej rreth 18 m nga kulla gjysmërrethore. Hyrja e kullës, me gjerësi 1,70 m, ndodhet pranë këndit perëndimor, më afër hyrjes së vogël të fortifikimit. Në hapësirën e jashtme, kulla është e qitur rreth 1,35 m përtej vijës së shtrirjes së bedenave. Muri i bedenit juglindor është ruajtur pranë kullës gjysmërrethore në lartësinë 0,70 m, kurse në kullën drejtkëndore është zbuluar në lartësinë 1,60 m. Përgjatë murit perëndimor të kullës drejtkëndëshe, lart në murin e bedenit, ndodhet një portë e vogël me gjerësi 1,30 m (Fig. 3/5). Qasja e portës u bë e mundur me ndërtimi e shkallëve (tre shkallë me lartësi mesatare 0,30 m), të punuara me teknikën e murit të thatë.

Në fazën e dytë të ndërtimit u ngrit bedeni i jashtëm, me gjatësi rreth 35 m (Fig. 3/6). Ka të njëjtën gjerësi si i mëparshmi dhe është punuar me teknikën e njëjtë të ndërtimit. Mbështetet pas kullës gjysmërrethore jugore, përhapet butësisht në drejtim të lindjes, e më pas lakohet ashpër në drejtim të juglindjes, duke ndjekur konfigurimin e terrenit. Bedeni mbështetet pas kullës gjysmërrethore duke bërë një kënd të ngushtë, për të siguruar stabilitetin statik. Bedeni i jashtëm ndërpritet menjëherë poshtë faqes lindore të kullës drejtkëndore, ndërsa degët e tija përputhen duke formuar kështu portën me gjerësi 1,60 m (Fig. 3/7). Në vijë me këndin lindor të kullës drejtkëndëshe, nga bedeni i ri shtrihet një mur i tërthortë me të njëjtën gjerësi, i cili me qoshen e kullës formon hyrjen në hapësirën brenda bedenave. Gjerësia e kësaj hyrjeje nuk është përcaktuar, sepse konstatuam dëmtimin e kornizës veriore të derës, por mund të supozohet se nuk është më e gjerë se 1.5 m. (Fig. 3/8). Në këtë mënyrë u formuan tre kalime të cilat vështirësojnë qasjen në fortifikatë dhe mundësojnë mbrojtjen dhe kontrollin më të lehtë. Në pjesën ku lidhet me kullën gjysmërrethore, bedeni është ruajtur mirë në zonën e themelit, kurse në disa vende, në anën perëndimore, është zbuluar vetëm bërthama e tij e brendshme. Duke shkuar në drejtim të lindjes, bedeni është ruajtur më mirë, kështu që lartësia e tij në afërsi të kullës drejtkëndore është rreth 1,50 m.

KOMPLEKSI SAKRAL

Në hapësirën ndërmjet kullave të zbuluara në anën juglindore dhe bedenit jugperëndimor, u formua një pllajë pothuajse e sheshtë trekëndore mbi të cilën u ndërtua kisha me aneksin verior (Fig. 3 / I) dhe një ndërtesë drejtkëndëshe e pallatit të klerit (Fig. 3 / II). Pllaja me ndërtesa është e rrethuar në anën veriore dhe verilindore me blloqe guri dhe shkëmbinj, të cilat zbresin rrëpirë në pllajën e poshtme e cila është rreth 8 m më e ulët. Në këtë mënyrë është ndarë akropoli me ndërtesat sakrale nga pjesa tjetër e fortifikatës.

Kisha, me përmasa të jashtme 11.70 x 6.00 m. (Fig. 3 / I), u ndërtua në skajin e pjesës veriperëndimore, në pikën më të lartë të pllajës trekëndore të akropolit. Ka orientim lindje-perëndim me një devijim të lehtë në drejtim të veriut. Në anën lindore ndodhet një absidë e thellë gjysmërrrethore, kurse në anën perëndimore gjendet hyrja me gjerësi 1,25 m. Në kishë ka edhe dy hyrje të tjera, veriore dhe jugore, pothuajse me të njëjtën gjerësi (0,95-1,00 m), të lëna më afër krahëve të brendshme të absidës. Muret e kishës janë me gjerësi 0,70 m, të punuara me blloqe guri të papërpunuar dhe të gdhendur, të stivuar në rreshta horizontale mjaft të rregullt dhe të lidhur me llaç gëlqereje. Në bazë të blloqeve të gjetura të stalagmit, mund të supozohet se kisha ishte e ndriçuar përmes dritareve të hapura në pjesën qendrore të naosit, në anën veriore dhe jugore. Nuk kemi të dhëna materiale për ekzistencën e dritareve mbi hyrjen qendrore dhe në boshtin e absidës. Të gjitha çeljet në kishë (dyert dhe dritaret) kishin fasadë me blloqe të stalagmit, të zbukuruara në mënyrë fine. Dyshemeja e kishës është bërë me suva të kuqe rezistente ndaj ujit.. Në zonën e absidës, derës jugore dhe krahut të brendshëm jugor të kishës, baza shkëmbore u hoq duke e skalitur deri në nivelin e dyshemesë së mëparshme. Absida e kishës ishte ndërtuar mbi shkrepë, kështu që niveli i themelit të saj u formua rreth 1 metër poshtë niveli të dyshemesë. Muret e kishës janë zbuluar në gjendje mjaft të keqe dhe janë ruajtur në lartësinë 0.50 m në anën perëndimore deri në 1.20 m në anën lindore. Dëmtimet më të mëdha janë konstatuar në faqen e brendshme të murit të absidës, e cila u ruajt në lartësinë e dy rreshtave blloqesh guri (0,30 m).

Në fazën e dytë të ndërtimit, në anën veriore të kishës, u shtua një aneks me një absidë të cekët, të mbështetur pas krahut verior të kishës dhe

hyrjes së kthyer nga jugu. Aneksi është me gjatësi 12,40 m dhe me gjerësi të pabarabartë, nga 2,90 m në perëndim deri në 3,53 m në lindje. Një formë e tillë e çrregullt është e kushtëzuar nga konfigurimi i terrenit dhe drejtimi i shtrirjes së shkëmbinjeve të rrëpirët buzë akropolit. Aneksi është më i gjatë se kisha për gjerësinë e derës (1,10 m) së hapur në anën jugore. Pozicioni i hyrjes në *peraklis* kushtëzohet edhe nga pozicioni i bedenit jugperëndimor. Muri jugor i *peraklisit* shtrihet nga këndi veriperëndimor i kishës, deri në murin e bedenit, duke mbyllur qasjen e kishës dhe akropolit nga ana veriore. Muret e aneksit janë me gjerësi 0,60 m dhe janë punuar me të njëjtën teknikë si muret e kishës, nga blloqe guri të papërpunuar dhe të gdhendur, të stivuar në rreshta horizontale mjaft të rregullt dhe të lidhur me llaç gëlqereje me agregat të madh lumi. Muret janë të ruajtur keq, me lartësi nga 2 deri në tre rreshta blloqesh guri. Dyshemetë e aneksit janë të devastuara, mirëpo në bazë të mbetjeve të zbuluara përgjatë murit jugor mund të thuhet se janë punuar me teknikë të njëjtë si dyshemeja e kishës.

Në anën juglindore të akropolit, në hapësirën ndërmjet hyrjes së vogël të fortifikimit dhe absidës së kishës, u ngrit objekti me përmasa 6,25 x 5,13 m. (Fig. 3 / III). Ndërtesa shtrihet paralelisht me drejtimin e shtrirjes së bedenave, duke formuar kështu një lloj kalimi për në kishë, me gjerësi 1,70 m. Ky kalim, nga hyrja e vogël në kala, shtrihet deri në kullën gjysmërrrethore në anën perëndimore. Muret e objektit, me gjerësi 0,60 m, janë bërë me blloqe të mëdhenj guri, të papërpunuar ose të gdhendur, të stivuar në rreshta horizontale mjaft të rregullt dhe të lidhur me llaç gëlqereje me agregat të madh lumi. Janë ruajtur në lartësinë nga 0,55 m në anën veriore deri në 1.20 m në anën jugore. Në anën perëndimore, përgjatë këndit jugperëndimor të objektit, është lënë hyrja me gjerësi 1,60 m. Ky objekt përfshin edhe mbetjet e murit në anën perëndimore, i cili harkohet drejt kullores së kullës gjysmërrrethore, duke formuar në këtë mënyrë kalimin me gjerësi 1,90 m. Mund të supozohet se ky mur shtrihej deri në murin perëndimor të pallatit, duke formuar kështu një lloj hajati të mbuluar. Ekziston një mundësi e arsyeshme që ky mur është mbetje e ndonjë objekti nga faza e parë e ndërtimit të fortifikatës.

ARKITEKTURA E BANIMIT

Gjatë gërmimeve arkeologjike sondazhuese, të ndërmarra në vitin 2008, u zbuluan mbetjet e një objekti i cili gjendet në pllajën mu poshtë akropolit, në anën lindore të fortifikatës (Fig. 3 / III). Më saktësisht, ndodhet poshtë kullës drejtkëndore, kurse me anën e vet jugperëndimore është pjesërisht i ngulitur në shpatin e kodrës. Bëhet fjalë për objekt më të madh drejtkëndor, me përmasa 23 x 7,20 m, i cili, me anën e tij më të gjatë, shtrihet në drejtim të veriperëndimit. Me një mur tërthor, baza e objektit ndahet në dy hapësira pothuajse identike. Ndërmjet hapësirave, në murin ndarës, është lënë kalimi me gjerësi 1,20 m. Muret, me gjerësi 0,65 m, janë nga guri i papërpunuar dhe i skalitur, me të njëjtën teknikë si muret e objekteve tjera të zbuluara. Duke pasur parasysh trashësinë e mureve dhe faktin se objekti është pjesërisht i ngulitur në shpatin e kodrës, mund të supozojmë se kishte edhe katin që ishte në nivelin e hyrjes së vogël në fortifikatë.

STRATIGRAFIA

Gërmimet në Tumbarice u realizuan me metodën që përdoret në pothuajse të gjitha gërmimet e mbetjeve arkitekturore të objekteve dhe tërësive urbane. Në terren u vendos rrjeti katror, sipas sistemit të koordinatave, me katrorë me përmasa 4 x 4 metra. Pika zero e sistemit të koordinatave u vendos në këndin e jashtëm, jugperëndimor të kishës (Fig. 5). Në absidë, nga pika zero në drejtim të lindjes, katrorët janë shënuar me shkronja të mëdha latine, kurse në drejtim të perëndimit me shkronja të vogla latine. Në ordinatë, nga pika zero në drejtim të jugut, katrorët janë shënuar me numra romakë, kurse në drejtim të veriut me numra arabë. Me gërmimin e alternuar të katrorëve (me sistemin e fushës së shahut), u formuan profile që shtrihen në mënyrë tërthore nëpër kullën drejtkëndore dhe janë pingul me drejtimin e shtrirjes së bedenave në anën juglindore. Në profile janë veçuar qartë shtresat stratigrafike, të cilat, në bazë të materialit të luajtshëm arkeologjik, janë përcaktuar kronologjikisht dhe dëshmojnë për ngjarjet historike dhe jetën në këtë pozicion thuhet të fortifikuar natyrshëm. Këto horizonte banimi janë shënuar dhe përpunuar nga më i thelli dhe

më i vjetri tek më i riu, duke e mbyllur me kohën e rrënimit përfundimtar të fortifikatës. Në bazë të shtresave që dallohen për nga ngjyra, tekstura dhe përmbajtja e materialit të luajtshëm arkeologjik, mund të veçohen pesë horizonte të jetesës në këtë lokalitet:

I - vendbanimi parahistorik kodrinor,

II - periudha iliro - helenistike,

III - periudha nga ndërtimi i fortifikatës, në mesin e shekullit II deri në kohën e rrënimit të saj, në gjysmën e dytë të shekullit III,

IV - periudha e rindërtimit të fortifikatës në shekullin IV deri në braktisjen e saj në fund të shekullit V.

V - periudha e rindërtimit të fortifikatës në shekullin VI deri në shkatërrimin përfundimtar në fillim të shekullit VII.

Vendbanimi parahistorik kodrinor

Tumbarice kanë pozicion natyror të mbrojtur mirë, me pllaja të shkallëzuara e të përshtatshme për popullim. Pikërisht në këtë hapësirë, gjatë gërmimeve arkeologjike sistematike, janë zbuluar gjurmë të shtresave parahistorike. Fatkeqësisht, për shkak të ruajtjes së dobët të tyre, të kushtëzuar nga ndërtimet intensive në epokat e vona dhe nga efekti shekullor i erozionit, njohuritë tona për horizontet më të vjetra të jetës në këtë kodrinë për momentin janë vetëm fragmentare. Duhet pasur parasysh se në periudhën e deritashme është humtuar një sipërfaqe relativisht e vogël, ndaj edhe kjo shtresë është konstatuar në një hapësirë mjaft të kufizuar. Gjurmët e shtresave parahistorike janë gjetur në Objektin III (Fig. 3 / III), në zonën e pjesës perëndimore të akropolit dhe në hyrjen e kullës së madhe drejtkëndore (Katrorët: AI, AII, AIII, BII, BIII dhe FIII). Pavarësisht se materiali parahistorik i përket një diapazoni të gjerë kronologjik, për momentin ai i përket një horizonti të banimit.

Ndër gjetjet arkeologjike, të cilat horizontin më të vjetër në Tumbarice e përcaktojnë në fund të neolitit ose në fillim të eneolitit, më të shumtë janë fragmentet e enëve më të mëdha – vorba të punuara nga argjila me miksturë rëre, me sipërfaqe të jashtme të lustruara, me baltë ngjyrë të kuqe të mbylltë dhe kafe të mbylltë. Krahas vorbave, bien

në sy fragmentet e amforave me qafë cilindrike dhe me qark të sheshtë, pak të pjerrët nga brenda (kat. Nr. 1,2). Amforat, rregullisht, janë të pajisura me dorëza në formë tuneli, të shpuara horizontalisht, prej të cilave veçohet njëra me formë sqepi (kat. nr. 5). Tek enët më të vogla, me sipërfaqe të jashtme të lustruara, baltë ngjyrë kafe të mbylltë, bien në sy dy fragmente enësh. Një fragment i qarkut të enës me qafë të shkurtë cilindrike dhe qark të pjerrët nga brenda (kat. Nr. 7) dhe tjetri fragment i krahut të një ene më të thellë, me profilacion të rrumbullakosur, i zbukuruar me kanelyra të pjerrëta, të gjera dhe të cekëta (kat. nr. 8). U gjet një enë bikonike në miniaturë, me dorëza të vendosura përballë, të shpuara vertikalisht. (kat. nr. 4). Pjesë e prodhimi nga qeramika është edhe gjetja e një peshe qeramike për rrjetë (guri i peshores), i fragmentuar, në formë topi (kat. 6). Krahas materialit qeramikë, veçohen edhe tre sëpata të fragmentuara, të lustruara në mënyrë fine, të bëra me kallëp nga guri i imët ngjyrë gri (kat. nr. 9). Nga objektet e bëra me teknikën e përpunimit të gurit, spikat një zdrukth, i punuar në një lamelë të shkurtër, me prerje trapezoide (kat. nr. 10) dhe një fragment thike të retushuar, me prerje trapezoide, me një pjesë korteksi të ruajtur (kat. nr. 11). Kësaj periudhe mund t'i atribuohet edhe gjetja e një fëndyelli të gjerë dhe të fragmentuar, të bërë nga segmenti i brinjës së kafshës (kat. nr. 12). Për këtë periudhë, analogjitë e materialit mund të gjenden në afërsi, në lokalitetin neolitik Beran krš, që gjendet në skajin veriperëndimor të luginës së Beranës dhe në vendin Trnje në fshatin Bijediće, afër Bijello Poles (Marković, 1985: 53- 70, T. LIV / 4,7; T. LVIII / 7; T. LIX / 1).

Epoka e bronzit të hershëm përfshin fragmente qeramike enësh, të punuar nga dheu me miksturë rëre më të imët dhe në disa raste me kokrriza më të mëdha. Në rastin e fragmenteve të enëve më të mëdha, sipërfaqet janë përpunuar mirë dhe krijohet përshtypja se janë të lyera me argjilë të lëngshme, kështu që kryesisht janë me baltë ngjyrë mat, me nuanca të kuqe okër, gri dhe kafe të mbylltë. Numri më i madh i fragmenteve i përket vorbave me qafë më të gjatë konike dhe qark të trashur nga ana e jashtme (kat. nr. 13). Shumica e enëve nuk ishin të zbukuruara, me përfundim që në qark vërehet shiriti plastik me gjurmë të thonjeve, kurse tek enët me madhësi të mesme zbukurimi bëhej me ashpërsimin e qëllimshëm të sipërfaqeve të jashtme, me teknikën *barbotina* (kat.

nr. 15) dhe me ornamente (kat. nr. 17). Bie në sy një fragment i barkut të enës i zbukuruar me shiritat të gërvishtura në formë paralele, të mbushur me ornamente rrjete (kat. Nr. 16) dhe një fragment i enës, i zbukuruar me kanelyrë në kombinim me gërvishtje (kat. nr. 14). Ndër gjetjet prej guri spikat fragmenti i një tavoline pune, i punuar me guri të trashë në formë pllake dhe fragmenti i një sëpatë guri të shpuar dhe punuar nga guri i imët me ngjyrë të gjelbër (kat. nr. 18).

Materiale të epokës së bronzit të hershëm u gjetën edhe në kodrinat tjera në Polimle, të cilat u gërmuan pjesërisht ose vetëm u sondazhuan, e ato janë: Gradac në Budimlje, Samograd, Gradac në Crnča dhe në lokalitetin shumështrësor Torine në Radmanska klisura (Lutovac, 2008:2: -275). Analogjitë për këtë material mund të gjenden edhe në afërsi, në kështjellën Ras afër Novi Pazarit (Popović, 1999: 54, Fig. 17). Duhet të theksohet se nuk ka paralele më të afërta në, përndryshe, pak site të hulumtuara të epokës së bronzit të hershëm në Serbi dhe Mal të Zi. Megjithatë, orientimin më të afërt kronologjik dhe kulturor të kësaj periudhe duhet kërkuar në zona të largëta, siç janë horizontet kulturore në sitet Varvara A1 në Bosnje (Čović, 1978: 46-54) dhe Maliq IIIa në Shqipëri (Prendi dhe Bunguri, 200: 46-81).

Epokës së zhvilluar ose më të vjetër të hekurit i përkasin fragmentet e një amfore me qafë të lartë konike dhe qark pak të lakuar nga i cili fillon dorëza e lartë me prerje tërthore poligonale (kat. nr. 19). Amfora, poshtë qarkut, është e zbukuruar me një kenelyrë të ngushtë të gërvishtur horizontalisht, nën të cilën shfaqen kenelyrat e pjerrëta dhe të thella. Amforat me formë të tillë dhe dekorimi me kanelyrë kanë analogji të dëshmuar, nga njëra anë në qeramikën "besarabi", dhe nga ana tjetër në qeramikën me kanelyrë (post-besarabi) (Stoić, 1977: 315-322; Kapuran, 2014 :). Epokës së hershme të hekurit mund t'i atribuohet edhe gjetja e një dorëze me trashje konike në pjesën më të lartë, që mund t'i përkiste kulturës së Brnjicës (mne. brnjičkoj kulturi) (Tasić, 1977: 284-299). Periudhës së ndërmjetme (kalimtare) dhe epokës së hekurit i takojnë një numër i madh i fragmenteve të vorbave të mëdha dhe të vogla me qark të futur dhe të zbukuruar me faseta horizontale ose të pjerrëta. Veçohen fragmentet e vorbës më të madhe, me dorëza më të mëdha horizontale, qark të zbukuruar me faseta të shkurta dhe të pjerrëta dhe me zgja-

time lythore (kat. nr. 23). Epoka e hekurit përfshin fragmente enësh të zbukuruara me gdhendje (kat. Nr. 21) dhe motive me kanelyrë (kat. nr. 22).

Kësaj periudhë mund t'i përkasë themeli i shtëpisë së rrënuar, të zbuluar në kv.BIII, i cili u shkatërrua nga ndërtimi i bedenave në fazën e parë të ndërtimit. Bëhet fjalë për një objekt drejtkëndor, nga i cili është ruajtur themeli i ngritur dhe i brinjëzuar, i punuar nga argjila e kuqrrremtë me miksatyrë guri. Në bazë të fundamentit të ruajtur, del qartë se gjatë ndërtimit të kësaj njësie të banimit, vigu është formuar me rreshtimin horizontal të trave. Është ruajtur edhe një pjesë e dyshemesë së pjekur të shtëpisë.

Periudha iliro – helenistike

Fragmente të rralla qeramike, gjetja e një monedhe argjendi dhe një fibul bronzi i përkasin fundit të epokës së hekurit, më saktë periudhës së shtetit ilir, të shënuarë nga ndikimet e forta të botës helenistike. Me ndërtimin e fortifikatës së parë romake në Tumbarice, shtresat e kësaj periudhe të banimit, u shkatërruan plotësisht. Nuk kemi të dhëna materiale për veprimtarin ndërtimor që do t'i përkiste kësaj periudhe kronologjike, sepse mbetjet e mundshme arkitekturore të periudhës ilire u rrënuan pothuajse plotësisht nga ndërtimet e fortifikatave dhe objekteve në periudhat e mëvonshme. Në shtresën e rrafshimit të terrenit, në pjesën e brendshme të bedenave nga faza e parë (shtresë nga guri i grimcuar dhe shumë gur të vegjël e të mëdhenj), u gjet një dorëz e fragmentuar e skifosit (kat. nr. 24) dhe një fund më i trashë me gjurmë të një shtrese të zezë - firnis (kat. nr. 25). Fragmentet i përkasin qeramikës Gnatia - një lloj i njohur në sitet e Dalmacisë e deri në Hercegovinë dhe Bosnje (Bešlić, Garašanin, Garašanin, Kovačević, 1967: 122,123). Përfaqësohet pothuajse në të gjitha fortifikatat dhe qytetet e fortifikuara në trevën e Malit të Zi, e të cilët i përkasin periudhës së shekullit III - II para erës sonë. Para së gjithash në Risan, Budva dhe Ulqin, Medun dhe Samobor (Bešlić et al., 1977: 118 etj.). U gjetën edhe fragmente të një kupe me dorëza të harkuara vertikale. Këto fragmente u gjetën në katrorin BIII, në të cilin u kryen kërkimet deri në shtresën shkëmbore të terrenit. Gjatë pastrimit të bazamentit shkëmbor, në katrorin BII, u gjet një fibul bronzi, me trup në formë gjetheje shelgu dhe një bazë katrore të zgjatur horizontalisht, skajet e së cilës janë të ngritura vertikalisht. Nga trupi i trashur dhe i brinjëzuar i fib-

ulës lakohet një hark i lëmuar, mbi të cilin ruhet një çelje për fiksimin e boshtit që mban mbështjelljet e telit dhe gjilpërës për mbërthim. Bazuar në llojin e bazës së zgjatur, mund të supozojmë se fibula kishte dy gjilpëra. Në shpatin perëndimor, në një përroskë jashtë kalasë, u gjet një monedhë argjendi e mbretit Maksata, e farkëtuar në Durrës, pas vitit 229 p.e.s.

Periudha e dominimit romak

Horizonti i tretë i jetës është koha e ndërtimit të fortifikatës së parë në fund të shekullit II dhe më së voni në fillim të shekullit III pas Krishtit, e deri në shkatërrimin e saj në gjysmën e dytë të shekullit III. Mund të supozojmë se atëherë u ndërtua objekti III, i cili ndodhet në pllajën poshtë kullës drejtkëndore. Nuk kemi asnjë provë materiale për ekzistencën e objektit në akropol që mund t'i atribuohet këtij horizonti. I gjithë materiali i luajtshëm arkeologjik i kësaj periudhe u gjet përgjatë bedenit të brendshëm dhe diç në kullë drejtkëndore. Krahas fragmenteve të rralla të enëve qeramike, me ngjyrë gri dhe sipërfaqe të lustruara që të kujtojnë formën *La Tène*, veçohet një fragment ene më të vogël (kupë ose vorba) me qark të sheshtë dhe të trashë nga ana e jashtme (kat. nr. 28.). Është bërë prej argjile të pastruar mirë, baltë ngjyrë kuqe të çelët dhe vernik ngjyrë kuqe. Cilësia e sipërfaqeve të trajtuara dhe ngjyra e vernikut në enë janë të ngjashme me qeramikën romake të Ulpianës, ku datohen në gjysmën e dytë të shekullit II dhe gjysmën e parë të shekullit III (Fidanovski, 1990: 26). Në shtresat që i takojnë këtij horizonti janë gjetur dy monedha argjendi dhe një bronzi. Monedhë argjendi e Julia Domna (kat. nr. 31), monedhë bronzi më e madhe e Marcus Iulius Philipus (kat. nr. 30) dhe monedhë argjendi e Licinius Valerianus (kat. nr. 29). Në bazë të shtresave të blazës dhe hirit, mund të themi me siguri se kjo fortifikatë u rrënuar në fund të shekullit III, si dhe fortifikata në Samograd, e ndoshta edhe të gjitha fortifikatat tjera në Polimle.

Periudha romake e vonë – krishterimi i hershëm (paleokrishterimi)

Në bazë të materialit qeramikë që është identik me atë të gjetur në Samograd (Mrkobrad dhe Jovanović, 1989: 43, T.III dhe T: IV) mund të themi me siguri se fortifikata në Tumbarice është ri-

novuar në shekullin IV, në kuadër të rinovimit të organizuar të fortifikatës në kohën e Dioklecianit ose Konstandinit I. Krahas një morie fragmentesh qeramike, kryesisht vorba dhe kapakë, kësaj periudhe mund t'i atribuojmë edhe fragmentet e një krehri me dy rreshta të përbërë nga tre pjesë. Krehri është në formë drejtkëndëshe, me faqe të sheshta. Pjesa e mesme ndërmjet dhëmbëzave është e përforcuar me pllakë drejtkëndëshe të zgjatur, nga të dyja anët, të cilat mbërthehen me vidhë hekuri. Në pllakë vërehen shenja prerjesh të krijuara gjatë vendosjes së dhëmbëzave, të cilët nga njëra anë janë më të gjerë, kurse nga ana tjetër më të ngushtë. Për këtë lloj gjetjeje ekzistojnë analogji të shumta, nga të cilat veçojmë gjetjen në Singidunum (Petković, 1995: 57, kat. Nr. 5, TI / 2), pastaj nga Gradina na Jelica (Milinković, 1975: Abb, 18). / e), gjetjet nga shtresa e Bizantit të hershëm në kështjellën Ras-Pazarište pranë Novi Pazarit (Popović, 1999: 110-120, 321, kat. nr. 151-162, fig. 1,2) dhe Pontes në Đerdapski limes (Špehar, 2010: 120, T. XXXV / 626, fig.66). Të njëjtës periudhë i përket një fragment i kopsës prej bronzi me cepa pak të theksuara që është i ngjashëm me ekzemplarë të gjetur në Đerdap në Dijana (Špehar, 2010: 55, kat. nr. 52) dhe atë nga Feliks Romuliana afër Zaječarit (Živić, 2003: 147, kat.nr.396), e cila duhet pranuar me rezervë.

Sa i përket veprimtarisë ndërtimore, këtij horizont mund t'i atribuohet rinovimi i bedenit të vjetër dhe ndërtimi i të riut në anën juglindore të fortifikatës. Në akropol u ndërtua një kishë paleokristiane, e, me gjasë, edhe një pallat klerik. Në bazë të ndërshtresave të hirit, mund të supozojmë se fortifikata është përdorur deri në mesin e shekullit V. Kjo ndërprerje e shfrytëzimit të fortifikatës u konstatua edhe në fortifikatën e Samogradit dhe nuk dihet arsyeja e braktisjes së tij.

Periudha e bizantit të hershëm

Fortifikimi u ripërdor dhe pjesërisht u rindërtua në shekullin VI në kuadër të restaurimit të *limesit* të brendshëm nga Justiniani (Mirković, 1978: 1-8; Nikolajević, 1976: 202 et seq.). Gjatë kësaj periudhe u restauruan bedenat dhe kishës iu shtua *paraklisi* verior. Në bazë të morisë së gjetjeve të luajtshme arkeologjike, mund të themi se ky fortifikim mbijetoi deri në ardhjen e avarëve dhe sllavëve në fillim të shekullit VII, kur u shkatërrua

plotësisht. Nga 510 gjetje të luajtshme arkeologjike, numri më i madh i përket këtij horizonti të banimit. Në sipërfaqen e tërësishme e cila ishte lëndë e hulumtimeve tona, në tërësi është hulumtuar horizonti më i ri i banimit (shtresa e dheut ngjyrë kafetë mbylltë me blozë dhe hi) deri në nivelin e shtresës së suvasë të krijuar në fazën e fundit të rinovimit të kësaj fortifikate. Numri më i madh i gjetjeve u zbulua në hapësirën ndërmjet bedenave. Në kishën me aneks pothuajse nuk kishte gjetje të luajtshme, gjë që është krejtësisht e kuptueshme, sepse dyshemetë e tyre janë më të larta në krahasim me tokën e akropolit. Gjetjet më të rëndësishme u zbuluan para hyrjes në hapësirën e pallatit (në hajat) dhe në drejtim të hyrjes në kullën gjysmërrethore. Në këtë pjesë u gjet gruri dhe disa lloje thjerrëzash të karbonizuara gjatë djegies së objekteve në fortifikatë. Në nivel me drithërat e karbonizuara janë gjetur pjesë të garniturave të brezit, të cilat e përcaktojnë qartë kohën e prishjes së kësaj fortifikate. Nga moria e materialeve të luajtshme arkeologjike kemi veçuar pjesën që dëshmon për rëndësinë ekonomike të fortifikatës në Tumbarice. Fillimisht ato që flasin për veprimtarinë ndërtuese, përpunimin e gurit dhe drurit. Mjete për përpunimin e drurit dhe gurit dhe një numër i madh pykash të ndryshme hekuri u gjetën pothuajse në të gjitha vendet në Polimle. Të gjitha muret dhe ndërtesat brenda fortifikimit janë nga guri i gdhendur dhe i papërpunuar, i lidhur me llaç gëlqereje, me teknikën e *opus incertum* (Basler, 1972: 30-31). Konstruksionet e çatisë janë punuar prej druri, të lidhura me pyka dhe materiale hekuri. Në objektin rezidencial është konstatuar prania e xhamave në dritare. Grilat në dritare dëshmojnë nga çivitë e thjeshta ose ato pak më luksoze dhe të dekoruara, që u gjetën në anën lindore të ndërtesës II. Sa i përket ndriçimit brenda godinave, nuk kemi shumë gjetje. Konteksti në të cilin u zbuluan pjesë të pajisjeve të ndriçimit në veri të Ilirisë, si dhe analogjitë përkatëse nga pjesë të tjera të Perandorisë, tregojnë se lloji i pajisjeve të përdorura për ndriçim nuk varej nga karakteri i ndërtesës (Špehar, 2019: 331). Në Tumbarice janë gjetur fragmente të një *polielei* prej bronzi, i cili është përdorur për të ndriçuar kishën ose objektin II, në hyrjen e të cilit u gjetën fragmentet e tija.

Një numër i madh i fragmenteve të vorbave dhe i kapakëve me dorëz në formë butoni, që i përkasnin shekullit VI dhe gjysmës së parë të shekullit

VII, u gjetën në Tumbarice, kurse fragmente të ngjashme u gjetën në afërsi, në lokalitetet Vrsenica afër Sjenicës (Popović dhe Bikić, 2009: 146, fig. 52/18).) dhe Ras - Pazarishte afër Novi Pazarit (Popović, 1999: 108, fig. 57/13). Gjetjet e kupave dhe shtambave të ndryshme janë të rralla. Duhet theksuar se një numër i vogël i enëve të gjetura qeramike janë të lyera me vernik ose me gjurmë verniku. Gjetjet e kupave prej xhami me bazament ose e llambave janë të rralla dhe vetëm dy fragmente janë gjetur në Tumbarica (Špehar, 2010: 49, T. I / 37).

Numri më i madh i gjetjeve të zbuluara në Tumbarice i përkasin pjesëve të veshjeve dhe të stolive. Këto gjetje flasin për mënyrën se si vishen banorët, por dhe për nevojat dhe preferencat e tyre estetike. Behet fjalë për kopsa brezash, prej hekuri dhe bronzi, si dhe pjesë të garniturave të brezave. Llojet e kopsave të rripave, të trajtuara në këtë punim, hasen në një hapësirë të gjerë, nga vendi Đerdap (Špehar, 2010) deri në Caričin grad (Kondić and Popović, 1977), Gradina Jelice (Milinković, 2010; Milinković dhe Špehar, 2014), e deri tek vendet që ndodhen krejt afër: Ras - Pazarishte afër Novi Pazarit (Popović, 1999) dhe Vrsenica afër Sjenicës (Popović dhe Bikić, 1979). Meritojnë vëmendjen pjesët e brezit të artë, të vendosura me gjuhëzën e cila është objekti më i dalluar i kulturës avare (Bugajski, 2009: 188-189, fig.81). Mirëpo, kjo gjuhëz është me origjinë romane, duke gjykuar nga matrica e derdhjes (shkrirjes) të hasur në Caričin grad (Kondić dhe Popović, 1977: 191, T.VIII, fig.1).

Krahas këtij kompleti janë gjetur edhe kopsa të tjera brezash që i përkasin gjysmës së dytë të shekullit VI dhe gjysmës së parë të shekullit VII (Špehar, 2010: 151). Në vend të dytë, sipas numrit të gjetjeve, janë fibulat me bazament të zgjatur e të lakuar dhe me pseudo mbështjellës, te të cilat harku është i shtrirë në formë katrore dhe, pothuajse gjithmonë, zbukurohet me futjen e gjetheve të arit dhe argjendit. Bazamenti i brinjuar dhe i zgjatur është zbukuruar në të njëjtën mënyrë. Për nga pamja, këto fibula janë mjaft të ngjashme me atë të gjetur në Gradina në Jelica (Milinković, 2017: 104, kat. Nr. 46) dhe fibulan e gjetur në Pčelinje krš afër Žagubica (Milovanović dhe Filipović, 2018: cat. nr. 6.). Mirëpo, të gjitha analogjitë janë mjaft të ngjashme në formë, por këto të gjetura në Tumbarice janë unike dhe me gjasë janë vepër e mjeshtërve

vendas. Ky pretendim mbështetet nga gjetjet e veglave për përpunimin e metaleve në mënyrë fine (veglat e argjendarisë) si dhe shufrat e vogla prej ari dhe argjendi. Ky pohim dëshmohet edhe nga gjetjet e pjesëve të peshoreve të vogla dhe peshave prej bronzi. Fibulat në formë zogu i përkasin shekujve V dhe VI.

Në Tumbatrice u gjetën disa unaza hekuri me koka elipsoide, e më shpesh të rrumbullakëta ose katrore. Zakonisht, pllaka është zbukuruar me motive të gërvishtura në anën e sipërme, por këto paraqitje nuk vihen re dhe kryesisht janë zhdukur për shkak të korrozionit të fortë të metalit.

U gjetën një numër i madh shigjetësh prej hekuri, më shpesh ato me majë me tre tehe dhe një gjemb për fiksion. Kjo lloj shigjetëze është me origjinë aziatike dhe në trevat tona erdhi me valët e dyndjeve të popujve. Ato u përdorën gjerësisht nga avarët (Kovačević, 1977: 119; Mrkobrad, 1980: T. LXXXI / 11-13), dhe janë relativisht të zakonshme në sitet gepide në Panoni. Ato, pa dyshim, përdoren edhe nga ekuipazhet romane. Ato u gjetën në lokalitetet përgjatë limesit të Danubit (Špehar, 2010: 134, kat. nr. 696-708), por edhe në Caričin Grad (Kondić dhe Popović, 1977: 212, T. XXVIII / 102). Përveç një numri të madh të majave të shigjetave prej hekuri, në Tumbarice u gjet edhe fragmenti i tehut të shpatës prej hekuri zinxhiri i këllëfit të shpatës. Një numër i madh i monedhave prej argjendi dhe bronzi flet për një ekonomi të zhvilluar dhe marrëdhënie të forta tregtare me rajonin e gjerë.

SHQYRTIMET PËRFUNDIMTARE

Lumi Lim karakterizohet nga lugina pjellore, zgjerime lumore dhe kanione lehtësisht të kalueshme që nuk përbënin problem për lëvizjen e lirë nga burimi i tij, poshtë Bjeshkëve të Nemuna, deri në grykëderdhjen në lumin Drin. E pasur me ujë dhe lugina pjellore, kjo zonë ofron kushte të mjaftueshme për jetën e njerëzve dhe formimin e vendbanimeve dhe habitateve të para, duke filluar nga mezoliti e deri në ditët e sotme. Drejtimi i lumit, i cili rrjedh nga jugu në veri, mundësoi krijimin e një komunikimi natyror që lidhte zonën e Adriatikut me Ballkanin Qendror. Këto komunikime natyrore mundësuan popullimin e komuniteteve të para njerëzore që në fundin e epokës së

gurit të mesëm (Đurić, 1996: 75-102). Gjatë bashkësive të para bujqësore, në neolit, u krijuan një numër i madh vendbanimesh, nga burimi i Limit deri në grykëderdhjen e tij (Marković, 2006: 46 etj.; Derikonjić, 1996). Për momentin mundemi vetëm të supozojmë se në fund të neolitit, një vendbanim u themelua në Tumbarice, i ngjashëm me ata në afërsi, në Beran Krš, Torine dhe Trnje afër Bijello Poles (Marković, 2006: 53-70; Lutovac, 2008, 263-275). Fatkeqësisht, për shkak të përmasave të vogla të kërkimeve dhe nën ndikimin e ndërhyrjeve të mëvonshme, është shumë e vështirë të thuhet se në cilën pjesë të Tumbaricës ndodhej vendbanimi.

Duke filluar nga epoka e bronzit të hershëm, Tumbarica banohej si *refugium* natyror dhe në bazë të materialit të gjetur arkeologjik mund të supozojmë se vendbanimi, me ndërprerje të caktuara kronologjike, zgjati deri në fund të epokës së hekurit. Si horizont të veçantë banimi veçuam periudhën e shtetit ilir, në përbërjen e të cilit ishte me gjasë edhe lugina e Beranës. Ky pretendim mbështetet nga gjetjet në vendet tjera në luginën e Beranës, siç janë Gradac në Budimlja dhe Gradac në Jugovina. Në Gradac të Budimljës u gjetën fragmente të, të ashtuquajturave, “kupa të Megarit”, të zbukuruar me motivin e gjetheve që shfaqen rreth vitit 250 p.e.r. (Popović, 1986: 105-112). Një monedhë argjendi e Filipit V të Maqedonisë (221-179 p.e.r.) u gjet në Gradac në Jugovina. Në këtë periudhë është i dukshëm ndikimi i botës helenistike në mënyrën e fortifikimit të vendbanimeve tashmë ekzistuese, me ndërtimin e bedenave të mëdha “ciklopikë”. I tillë është rasti me Durrësin, Medunin, Risanin, Ulqinin, Samoborin (Mijović and Kovačević, 1975: 11 etj.) dhe qyteteve të tjera të formuara dhe të fortifikuara gjatë shtetit ilir. Për fat të keq, për shkak të aktiviteteve të mëvonshme ndërtimore dhe nivelit të vogël të gjurmëve, në Tumbarice nuk janë zbuluar mbetje të mureve dhe objekteve që i përkasin kësaj periudhe kronologjike. Megjithatë, gjetjet e zbuluara të monedhave prej argjendi dhe fragmente të qeramikës “Gnati” konfirmojnë rëndësinë e fortifikatës ilire në Tumbarice.

Në aspektin e popullsisë, pushtimet romake në Ballkan nuk e ndryshuan ndjeshëm situatën e deriatëhershme në Luginën e Limit. Kjo zonë u gjet në provincën romake të Dalmacisë. Mund të supozohet me shumë siguri se kufiri drejt Dardanisë fqinje dhe Mëzisë së Epërme kalonte përgjatë

skajit lindor të luginës së Limit dhe skajit perëndimor të rrafshnaltës së Peshterit. Kjo vijë kufitare përfshin fortifikimet përgjatë Drinit të Zi dhe degës së djathtë të tij, Valbonës (Bace, 1976: 45-46, harta 1) dhe përmes burimit të Ibrit zbret në Polimle, ku vija kufitare përbëhet nga fortifikimet në skajin verior të luginës së Limit (Mirković 1978: 1-8 Nikolajević, 1976: 202 etj.).

Kjo është, pa dyshim, një nga arsyet pse u ndërtuan fortifikatat përgjatë Polimles, në fund të shekullit II ose në fillim të shekullit III, në vendet ku ato ekzistonin gjatë periudhës ilire. Një arsye tjetër për krijimin e kësaj dhe të fortifikatave tjera në Polimle mund të jenë aktivitetet e rëndësishme të banditëve në këtë pjesë të provincës së Dalmacisë dhe Dardanisë fqinje (Mócsy, 1970: 194-198). Ata u qetësuan vetëm nga aksioni i Mark Aurelit (*Marcus Aurelius*), i cili rekrutoi një pjesë të tyre dhe i përfshiu në luftërat në Podunavle dhe në Panoni (Mrkobrad dhe Jovanović, 1989, 43) Gjurmët e blozës, tokës së djegur dhe qymyrit në horizontin III në Tumbarice tregojnë që fortifikata është rrënuar dhe djegur. Duke u bazuar në materialin qeramikë dhe monedhat prej bronz që i përkasin këtij horizonti, mund të pohojmë me siguri se ajo është shkatërruar në gjysmën e dytë të shekullit III. Arsyeja e drejtpërdrejtë për shkretimin e kësaj fortifikate, por edhe të fortifikatave tjera në Polimle, nuk dihet. Mirëpo, në bazë të pasqyrës së përgjithshme të ngjarjeve në krahinat fqinje mund të nxirret përfundimi i bazuar në rezervat e regjistruara të parave, në kohën e shkretimeve gotike të provincës së atëhershme të Dalmacisë dhe të Dardanisë fqinje. Në viset fqinje mund të supozohet në bazë të thesareve të regjistruara gjatë rrënimit gotik të provincës së atëhershme të Dalmacisë dhe të Dardanisë fqinje. Në rrethin e gjerë të Nikshiqit janë të njohura dy rezerva me monedha, të fshehura para rrezikut barbar, rreth viteve 230 dhe 260, ndërsa në Banjën e Pejës është evidentuar një rezervë, po ashtu nga viti 260. Duket se një sulm barbar (me gjasë gotik) mund të ndiqet nga Ponishevle (rezerva nga Nishi), Topolica (rezerva në Stari Momčilov), Kosova (rezerva në Banjën e Pejës) deri në Nikshiq (rezerva në Broqanac), (Mrkobrad i Jovanović, 1989: 43; Mirnik, 1981: kat.br. 195,231, 149, 157). Gjatë rrugës së tyre kaluan edhe në Polimle, kështu që u shkatërruan të gjitha fortifikatat që ishin pjesë e tij. Atëherë mund të ishte shkatërruar edhe fortifikata në Tumbarica.

Fortifikata u rindërtua në fillim të shekullit IV brenda sistemit të organizuar fortifikues të krijuar në kohën e Dioklecianit ose Kostandinit I. Në Tumbarice u rindërtua fortifikimi i vjetër dhe u ndërtua një mur i ri mbrojtës në anën jug-lindore. Mund të supozohet se në këtë periudhë kohore, në pllajën më të lartë të fortifikatës (akropol), është ndërtuar një kishë e vogël njëkëshe dhe një objekt rezidencial me formë katrore, i cili gjendet në jug të kishës. Supozimi ynë është se përballë këtij objekti rezidencial është formuar një hajat i mbuluar duke integruar një pjesë të murit të fazës së mëparshme të ndërtimit që ndodhet në anën perëndimore të objektit rezidencial. Ky mur nuk ka asnjë lidhje logjike me objektin rezidencial, kurse ana e tij jugperëndimore lakohet në formë harku në drejtim të kullores në kullën rrethore dhe formon një lloj kalimi me gjerësi 2,30 m. Duhet pasur parasysh se në fund të shekullit III ose në fillim të shekullit IV, provinca e Prevalisit u nda nga provinca e Dalmacisë (Kovačević, 1976: 241), dhe ruajti drejtimin e shtrirjes së vijës së dikurshme kufitare të provincës së Dalmacisë me Dardaninë dhe Mëzinë e Epërme.

Në bazë të stratigrafisë së konstatuar në Tumbarice, vërehet mungesa e materialit nga gjysma e dytë e shekullit V. Është e qartë që fortifikatat në atë kohë janë braktisur ose shkatërruar. Arsyeja logjike e largimit nga fortifikata është shfaqja e gotëve lindorë në kufijtë e Pravlisit rreth vitit 459 (Kovačević, 1960: 23-24). Më saktësisht, gotët lindorë ndoshta kanë hyrë në provincën e Prevalisit nga Epirin e Ri dhe mund të jenë vendosur afër Shkodrës, ku e ka origjinën një kopsë e dyfishtë, shumë e zbukuruar dhe me kokën e një zogu që, sipas formës, i përket stolive të gotëve të lindjes. (Kovačević, 1960: 23-24). Nën sundimin e Theodorikut (488-489), pas fitores kundër udhëheqësit gjerman Odoacer, gotët e lindjes pushtuan Dalmacinë dhe në kuadër të shtetit të tyre përfshinin pjesët perëndimore të provincës së Prevalis, zonën rreth Nikshiqit ku ndërtuan kështjellën Anagastum (Mijović dhe Kovačević), , 1975: 51).

Pas qetësimit të situatës me gotët lindorë, u rivendosën fortifikatat në Polimljës, në fund të shekullit V dhe në gjysmën e parë të shekullit VI. Ne e mbështesim këtë supozim me një mori objektesh metalike, veçanërisht monedha bronzi të gjetura në Tumbarice. Monedha më e re prej bronzi e

kësaj periudhe i përket Anastasia I (491-518), më pas Justin I (518-521), por u gjetën një numus dhe një folis i Justinianit I (527-565).

Me ardhjen në fron të Anastasius I (491-518), thesari i shtetit u forcua nga reformat e shumta. Krahas asaj ekonomike u ndërmorën edhe reforma ushtarake, brenda të cilave u rivendosën linjat mbrojtëse në kufi, duke restauruar të vjetrat dhe duke ndërtuar fortifikatat e reja (Špehar, 2010: 145). Nuk kemi dyshim se në atë kohë ka filluar rindërtimi i fortifikatave, të cilat ndodheshin edhe në kufijtë e brendshëm ndërmjet provincave ekzistuese. Këto masa u vazhduan me sukses nga pasardhësit e Anastasiusit, kështu që perandoria u rivendos gjatë sundimit të Justinianit I. Gjatë kësaj periudhe, muret ekzistuese në Tumbarice u rinovuan dhe kishës iu shtua peraklisi verior. Pasuria e gjetjeve të kësaj periudhe dëshmon për një seli të rëndësishme administrative dhe shpirtërore në Polimlje. Në kuadër të kësaj fortifikate, e ndoshta edhe të një qyteti më të vogël të fortifikuar, përveç qendrës shpirtërore, kishte edhe punishte farkëtarie për prodhimin e veglave të ndryshme, si dhe punishte argjendarie për prodhimin e stolive dhe veshjeve. Natyrisht, nevojiten kërkime të mëtejshme për të konfirmuar qartë të gjitha supozimet e bëra.

Gërmimet e deritashme sondazhuese të fortifikatës në Polimlje, si dhe ato sistematike në Tumbarice dhe Samograd, tregojnë për pasurinë e gjetjeve të paluajtshme dhe të luajtshme që i përkasin antikitetit të vonë dhe krishterimit të hershëm. Ekziston, pa dyshim nevoja për formimin e projektit tematik shumëvjeçar, realizimi i të cilit do ta bënte më të lehtë studimin e kësaj periudhe kronologjike gjatë ekzistencës së krahinës së Prevalisit, për të cilën, për momentin, kemi shumë pak të dhëna të shkruara.

KATALOGU I GJETJEVE



1. Fragment ene

Qeramikë, punë dore; dimensionet: 5,5 x 7,4 x 1,0 cm.

Katror: FIII -Rov/4.o.s. Muzeu i Polimles në Berane

Fragment i qarkut të amforës, me qafë cilindrike dhe qark të rrafshët, të punuar nga argjila me miksturë rëre, me sipërfaqe të rrafshuara. Balta ngjyrë okër në të kuqe.



2. Fragment ene

Qeramikë, punë dore; dimensionet: 7,1 x 6 x 0,8 cm

Katror: FIII -Rov/4.o.s. Muzeu i Polimles në Berane

Datohet në eneolit

Fragment i qarkut të amforës me qafë të lartë në formë konike, qarku i rrafshët dhe i trashuar nga faqja e jashtme. Punuar nga argjila me miksturë rëre, me sipërfaqe të lustruara. Balta me ngjyrë të kuqe të errët.



3. Fragment ene

Qeramikë, punë dore; dimensionet 5,8 x 5,5 x 08 cm;

Kvadrat: EIV/ 3.o.s; Muzeu i Polimles në Berane

Datohet në neolitin e vonë – eneoliti

Dorëz ene, në formë tuneli, të punuar nga dheu me miksturë rëre, me sipërfaqe të punuara në mënyrë fine. Balta me ngjyrë gri dhe të errët.



4. Enë miniaturë

Qeramikë, punë dore; dimensionet: lartësia 3,9 cm, diametri i çeljes së enës 3,6 cm, diametri i fundit 2,8 cm: Objekti III, gërmimet e vitit 2008, Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në neolitin e vonë – eneolit

Enë miniaturë, bikonike, me dorëza të vendosura përball njëra tjetrës, të shpuara vertikalisht, në formë brirësh. Punuar nga argjila me miksturë rëre të imët, me sipërfaqe të lustruara. Balta me ngjyrë okër dhe të errët.


	5. Fragment ene Qeramikë, punë dore; dimensionet: 4,5 x 4,6 x 08 cm; Katror; EIV/3.o.s; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në neolitin e vonë – eneolit Fragment i barkut të enës, me dorëz në formë tuneli, e tipit “sqep”, të punuar nga argjila me miksturë rëre, me sipërfaqe të lustruara. Balta me ngjyrë okër, gri dhe të errët. Dorëza ishte në përdorim sekundar.
	6. Gur (peshë) qeramik Qeramikë, punë dore; dimensionet: diametri 6.1 cm;; Katror; AIII /3.o.s; Muzeu i Polimles në Berane Datohet në neolitin e vonë – eneolit Gurë (peshë) e fragmentuar për rrjet, me formë rrethore, të punuar nga argjila me miksturë guri më të madh, me sipërfaqe të vrazhdë. Balta me ngjyrë të kuqe të errët.
	7. Fragment posude Qeramikë, punë dore; dimensionet: 4,3 x 5,1 x 0,7 cm; diametri 6,1 cm; Katror; FIV /1.o.s; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në neolitin e vonë – eneolit Fragment ene me qafë të shkurtë cilindrike dhe me qark të prerë nga brenda, të punuar nga argjila e pastruar, me sipërfaqe poroze dhe të lustruara në mënyrë fine. Balta me ngjyrë të errët.
	8. Fragment ene Qeramikë, punë dore; me dimensione: 6,1 x 6,4 x 0,6 cm. diametri 6,1 cm; Katror; FIV /1.o.s; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në neolitin e vonë – eneolit. Fragment ene, të punuar nga argjila me miksturë rëre, me sipërfaqe të lustruara bukur. Balta me ngjyrë të errët. Në pjesën e sipërme ena është zbukuruar me kanelyra të pjerrëta paralele.

	9. Sëpatë Gur, i lustruar; dimensionet: 6,4 x 3,9 x 1,8 cm; Katror; EIV/3 o.s. Muzeu i Polimles në Berane Datohet në fundin e neolitit – eneolit. Fragment i sëpatës të lustruar mirë, “e tipit kallëp”, me presë të ruajtur gjysmërrethore, të punuar nga guri grimcë imët, me ngjyrë gjelbër në gri.
	10. Zdrukth Gur, përpunim; dimensionet: 4,8 x 2,0 x 0,7 cm; Katror; FII /2.o.s; Muzeu i Polimles në Berane Datohet në neolitin e vonë – eneolit Zdrukth, me prerje trekëndëshe, të punuar nga guri me ngjyrë të bardh qumështi.
	11. Thikëz Gur, gdhendje; dimensionet 6 x 1,6 x 0,6: Gërmimet e vitit 2008; absida e kishës; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në neolitin e vonë – eneolit. Thikë prej stralli, me presë dhe një pjesë të korteksit bukur të retushuar, të punuar me prerje trapezoide, nga guri me ngjyrë mjalti.
	12. Vegël prej eshtre Eshtër, thyerje, lustrim; dimensionet: 6,3 x 1,6 x 0,3 cm; Katror; GII/ 3.o.s; Muzeu i Polimles në Berane Datohet në neolitin vonë – eneolit. Vegël e fragmentuar, e punuar nga cepi i brinjës së kafshës.

	13. Fragment ene Qeramikë, punë dore; dimensionet: 6,1 x 6,4 x 0,6 cm; Katror: FIV /1.o.s; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në eneolit – epoka bronzit të hershëm Fragment i enës me qafë konike dhe qark të trashuar nga jashtë, të punuar nga dheu me miksturë rëre të imët, me sipërfaqe të lustruara në mënyrë fine. Balta me ngjyrë okër.
	14. Fragment ene Qeramikë, punë dore; dimensionet; 3,6 x 3,1 x 0,8 cm; Katror; BII/2.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në eneolit – epoka e bronzit të hershëm. Fragment i barkut të enës, i zbukuruar me kenyrë dhe vija të gërvishtura, të punuar nga argjila me miksturë rëre të imët. Balta me ngjyrë okër dhe të errët.
	15. Fragment ene Qeramikë, punë dore; dimensionet; 3,6 x 3,1 x 0,8 cm; Katror: BII /2.o.s; Muzeu i Polimles në Berane Datohet në epokën e bronzit të hershëm. Fragment i barkut të enës, i zbukuruar me teknikën barbotina, të punuar nga argjila me miksturë rëre. Balta me ngjyrë të kuqe të mbylltë.
	16. Fragment ene Qeramikë, punë dore; dimensionet: 2,7 x 3 x 0,5 cm; Katror: BII /2.o.s; BII/2.o.s. Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në epokën e bronzit të hershëm. Fragment i enës më të vogël, i zbukuruar me shirita paralel në formë rrjete, të punuar nga argjila e pastruar mirë, me sipërfaqe të lustruara në mënyrë fine. Balta me ngjyrë gri.

	17. Fragment ene Qeramikë, punë dore; dimensionet: 2,7 x 3 x 0,5 cm; Katror: BII /2.o.s; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në epokën e bronzit të hershëm. Fragment i fundit të enës, i stolisur me ornamente, të punuar nga argjila me miksturë rëre të imët, me sipërfaqe të rrafshuara. Balta me ngjyrë të kuqe të mbylltë.
	18. Sëpatë Gur, gdhendje; dimensionet: 7 x 3,8 x 3,2 cm.; Katror GII/3. O. S.; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në epokën e bronzit. Sëpatë guri (çekiç) e shpuar dhe e përpunuar në mënyrë fine, të punuar nga guri me ngjyrë gri në të gjelbër.
	19. Fragment ene Qeramikë, punë dore, dimensionet: 3 x 2,1 x 0,6 cm; Katror: FIV /Pov.o.s; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet: epoka e bronzit të vonë.
	20. Fragment ene Qeramikë, punë dore; dimensionet: 9,2 x 9,4 x 0,6 cm, Katror; AII/1.o.s. Muzeu i Polimles në Berane Datohet në epokën e hekurit të vonë Fragment i amforës me qafë konike dhe qark të kthyer lehtë, ku fillon dorëza e lartë me prerje gati gjashtëkëndore. Punuar nga argjila me përqendrim të vogël të rërës së imët, me sipërfaqe të lustruara bukur. Balta me ngjyrë okër.

	21. Fragment ene Qeramikë, punë dore; dimensionet: 3 x 2,1 x 0,6 cm; Katror; FIV/Pov.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në epokën e hekurit të vonë. Fragment ene i stolisur me vija të gërvishtura, të punuar nga argjila me miksturë rëre të imët, me sipërfaqe të lustruara në mënyrë fine. Balta me ngjyrë okër të mbylltë dhe të errët.
	22. Fragment ene Qeramikë, punë dore; dimensionet: 3 x 2,1 x 0,6 cm; Katror; FIV/Pov.o.s. Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në epokën e bronzit të vonë. Fragmenti i barkut të një ene më të vogël të zbukuruar me kanelyra të pjerrëta, të punuar nga argjila me miksturë, me sipërfaqe të lustruara në mënyrë fine. Balta me ngjyrë okër në kuqe dhe të errët.
	23. Fragment ene Qeramikë, punë dore; dimensionet: 10,6 x 7,6 x 1 cm; Gërmimet e vitit 2008; kulla gjysmërrethore; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në epokën e bronzit më të vonë Fragment i enës më të madhe konike, me qark të futur brenda dhe të stolisur me kanelyra dhe me pjesë të nxjerra plastike. Ena është punuar nga argjila me miksturë rëre, me sipërfaqe të lustruara. Balta me ngjyrë okër dhe të errët.
	24. Fragment ene Qeramikë, e punuar në çikrik; dimensionet: 4 x 1,6 cm; Katror; CII/Rov; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në epokën e bronzit të vonë – helenizmi Dorëz e fragmentuara e skifosit, të punuar nga argjila e pastruar mirë, me shenja të vernikut me firnis. Balta me ngjyrë të kuqe.

	25. Fragment ene Qeramikë, e punuar me çikrik; dimensionet: diametri 4,7 cm, trashësia 2,7 cm; Katror: BII/Profil; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në epokën e bronzit të vonë – helenizëm Fragment i fundit masiv të enës (skifos ose kantharos), me shenja të vernikut të zi – firnis, i punuar nga argjila e pastruar bukur. Balta me ngjyrë okër.
	26. Maxata Argjendtë, farkëtim; Diametri 1,8 cm; Jashtë bedenave; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në shekullin III p.e.r. Monedhë ilire prej argjendi, e mbretit Maxata, e farkëtuar pas vitit 229 p.e.r. në Dirahion.
	27. Fibula Bronz, farkëtim, gërvishtje; Katror; BII/6.o.s Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në epokën e hekurit të vonë Fibula me hark në formën e gjethes së shëlgut, me pjesë katrore të zgjeruar në formë horizontale dhe cepa të ngritura vertikalisht. Harku është i lëmuar, ndërsa në kokë është ruajtur çelja për fiksimin e boshtit që mban mbështjelljet e telit dhe gjilpërat për mbërthim. Gjykuar nga pamja, duket se pjesa e zgjeruar kishte dy gjilpëra për mbërthim.
	28. Fragment ene Qeramik, e punuar me çikrik; dimensionet: 2,1 x 4,3 x 0,3 cm; Katror: BIII/4.o.s. Muzeu i Polimles në Berane Datohet në gjysmën e dytë të shekullit II dhe gjysmën e parë të shekullit III Fragmenti i enës me qark të rrafshët dhe të nxjerrë, me vernik ngjyrë kuqe, të punuar nga argjila e pastruar mirë. Balta me ngjyrë okër të çelur.

	29. Monedhë argjendi Monedhë, farkëtim; dimensionet: 2,2 x 0,2 cm; Katror; BIII/5.o.s. Muzeu i Polimles në Berane Licinius Valerianus (254 – 260).
	30. Monedhë bronzi Bronz, farkëtim; dimensionet: 2.9 x 0,3 cm; Katror; BIII/4.o.s Muzeu i Polimles në Berane Markus Julijus Filipus (244 – 249).
	31. Iulia Domna Argjendtë, farkëtim; Katror; GIV/1.o.s Muzeu i Polimles në Berane Julija Domna (211 – 217).
	32. Krehër Eshtër, prerje, gërvishtje; Katror; CIV/1.o.s. Muzeu i Polimles në Berane. Fragmente krehri me dy rreshta në formë kënddrejtë, me anësore të rrafshëta. Pjesa e mesit, ndërmjet dhëmbëzave, e forcuar me pjesën kënddrejte, të fiksuara me vidhë çeliku. Në pjesën fiksuese shihen shenja prerjesh të krijuara gjatë vendosjes së dhëmbëzave, të cilët nga njëra anë janë më të gjerë, kurse ana tjetër më të ngushtë.

	33. Kopsë Bronz, derdhje, përthyerje; Katror; BIV/1.o.s. Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në shekullin IV dhe gjysmën e parë të shekullit V? Pjesa e përparme e kopsës në formë katrori, me cepa lehtë të theksuar dhe pjesën qendrore të zgjeruara për vendosjen e gjembës.
	34. Kopsë Hekur, farkëtim, lakim; Poshtë kullës drejtkëndëshe në hapësirën ndërmjet bedenave. KvFIV / 1.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në shekujt III-IV Kopsa e brezit, omega, me formë rrethore, me prerje në formë rombi, me skaje të lakuara në volut, i cili është vertikal në raport me trupin. Gjemba, me prerje katërkëndëshe në rrënjë, ngushtohet pakëz në majën e thepisur.
	35. Gjuhëza e brezit Ar, derdhje, gërvishtje, stampim; dimensionet: lartësia 6 cm, gjerësia 2,4 cm, trashësia 0,4 cm; Katror BII/2.o.s. – Para hyrjes në kullën gjysmërrethore; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në fund të shekullit VI dhe në fillim të shekullit VII Gjuhëza, me formë të zgjatur kënddrejtë, me pjesën e poshtme të lakuar dhe të sipërmen të rrafshët. Në njërin anë një vijë e gërvishtur horizontale, kurse në anën tjetër dy. Më pranë cepit të rrafshët gjendet perforimi me vidhën që shërben për ta fiksuar në brez. Në anën e përparme, gjuhëza është e zbukuruar ndryshe, me stampimin e motiveve të ndryshme.



36. Një pjesë e garniturës së brezit

Ar, derdhje, gërvishtje, stampim; dimensionet: lartësia 1,8 cm, gjerësia 1,6 cm, trashësia 0,2 cm; Katror All/1.o.s. – Para hyrjes në kullën gjysmërrethore; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në fund të shekullit VI dhe në fillim të shekullit VII.

Aplikimi i artë në brez në formë mburoje, pjesë e garniturës së lartpërmendur. Në pjesën e përparme janë të stampuar dhe të gërvishtur motivet nga gjuhëza, ndërsa në pjesën e pasme dy shtyllëza, të radhitura vertikalisht, të cilët përfundojnë me çeljet e perforimit që shërbejnë për ta fiksuar në brez.



37. Gjuhëza e brezi

Argjend, derdhje, gërvishtje, përtsherje; dimensionet: lartësia 2,6 cm, gjerësia 1,8 cm, trashësia 0,3 cm. Katror; CIV/1.o.s. Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në fund të shekullit VI dhe gjysmën e parë të shekullit VII.

Gjuhëz brezi prej argjendi, me formë kënddrejte, me pjesën e poshtme të lakuar, e të sipërmen të theksuar me gërvishtjen e një vije horizontale. Në pjesën qendrore, poshtë vijës së gërvishtur, gjendet një, kurse sipër vijës gjenden dy çelje për fiksion në brez.



38. Gjuhëz brezi

Argjend, derdhje, shtypje, perforim; dimensionet; lartësia 3,3 cm, gjerësia 2,2 cm, trashësia 0,1 cm; Katror: Brendësia e kullës drejtëkëndëshe, Kv. GIII/3.o.s.

Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në shekujt V dhe VI.

Gjuhëza e brezit, me formë katrore, e punuar nga fleta e hollë, e zbukuruar, e argjendit, me thumba të ruajtur që shërbejnë për ta fiksuar në brez.

	39. Fibula Hekur, farkëtim, përkulje, gërvishtje, lyerje dimensionet: 5,5 x 1,8 cm; hapësira ndërmjet bedenave, katror: FIV / 1.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në gjysmën e parë të shekullit VI dhe fillimin e shekullit VII. Fibula prej hekuri, e "llojit të Ballkanit Perëndimor", me mbajtëse të kthyer dhe pseud mbështjellës. Harku i zgjatur në formë katrori është zbukuruar me gjethe gjatësore me të njëjtën gjerësi, dy prej ari anash dhe një prej argjendi në mes. Fusha qendrore, e argjendtë, është zbukuruar me dy prerje paralele zigzage. Mbajtësja e fibulës është e brinjëzuar dhe është zbukuruar në mes me një fletë argjendi dhe dy fleta flori në skaje, me të njëjtën gjerësi. Koka mbart një bosht. në skajet e të cilit është fiksuar një zgjatim. Një bobinë tjetër me të njëjtën madhësi dhe formë ndodhet në pjesën e përparme të kokës.
	40. Fibula Hekur, farkëtim, përkulje, gërvishtje, lyerje; Katror; FIV/2.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane. Datimi në gjysmën e dytë të shekullit VI dhe fillimi e shekullit VII. Fibula prej hekuri, e njëjtë si e lartpërshkruara. Mungon mbajtësja e kthyer me mbështjellës dhe gjilpëra. Në kokën e zgjeruar, në formë katrori, është gjetësi prej ari i zbukuruar me voluta të stampuara. Në anën e përparme dhe të pasme të mbështetësit, në mënyrë të tërthortë është vendosur fija prej ari.
	41. Fibula Hekur, farkëtim, gërvishtje; dimensionet: 2,8 x 0,5 cm; katror; AIII/Pov.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane. Datimi në gjysmën e dytë të shek. VI dhe fillimin e shek. VII Fibula e vogël prej hekuri, në formë zogu, me gjasë pëllumbi, me bisht pjesërisht të dëmtuar. Mungon gjilpëra dhe sistemi për fiksimin e saj.

	42. Fibula Hekur, farkëtim, gërvishtje, stampim, perforim; dimensionet: 2,9 x 1,1 x 0,3 cm; katrori: E3/ gjetje e rastësishme; Muzeu i Polimles në Berane; Datohet në gjysmën e dytë të shek. VI dhe fillimin e shek. VI Fibulë e vogël hekuri në formë zogut me kokë të qitur, me trup të zgjeruar në formë rrethore dhe bisht në formë trapezi. Bishti është i theksuar me vija të gërvishtura, ndërsa në kokë lythët e qitura personifikojnë sytë. Në mes trupit dhe bishtit një çelje e vogël për fiksime.
	43. Kopsë Hekur, farkëtim, gërvishtje; katror; CIV /1. o.s; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në gjysmën e dytë të shek. VI dhe fillimin e shek. VI Kopsë brezi me pjesë në formë trapezi dhe peshë në formë të zogut të stilizuar. Zogu është me trup cilindrik i cili zgjerohet pakëz kah koha e zgjeruar e cila është e lakuar kah pjesa e pasme dhe shërbente për fiksimin në rrip. Krahët janë të ndarë dhe të theksuara me gërvishtje të thella. Nga bishti e perforuar, e mbështjellë rreth traversës së pasme, gjemb e hollë, e lakuar pak që shtrihet në pjesën e përparme të kopsës.
	44. Kopsë brezi Hekur, farkëtim; dimensionet: 3,5 x 2,2; katror: CIV /1. o.s; Muzeu i Polimles në Berane; Datohet në gjysmën e dytë të shek. VI dhe fillimin e shek. VI Kopsëhekuri me peshë trekëndëshe me maje të rrumbullakosur dhe pjesën në formën e shkronjës latine D. Në peshë është gjemba me maje të lakuar e cila peshon në pjesën e parme të fjes.



45. Kopsë brezi

Bronz, shkrirje: 3,5 x 2,5 cm; katror: D3/ Gjetje sipërfaqësore; Muzeu i Polimles në Berane;

Datohet në gjysmën e dytë të shek. VI dhe fillimin e shek. VI

Kopsë bronzi me peshë ovale dhe fije zemre. Mbi peshën ovale është ruajtur qarku, ndërsa pjesa e brendshme është e dëmtuar. Gjembë që lidh peshën ovale me fillin ka rrënjë të trashur i cili ngushtohet në majin e lakuar e cila mbështetet në pjesën e përparme, të trashur, të fillit.



46. Byzilyk

Bronz, farkëtim, gërvishtje, punktim; Katror: CIV /1. o.s; Muzeu i Polimles në Berane;

Datohet në gjysmën e dytë të shek. VI dhe fillimin e shek. VI

Dy fragmente byzilyk me shirit më të gjerë me skaje të hapura dhe të zgjeruara në formën e kokës së gjarprit. Në kokë është një paraqitje e syve në formën e rrathëve me një pikë në mes. Midis syve është një rrip i ngushtë, i kufizuar nga dy vija paralele midis të cilave janë prerje paralele të tërthorta. Dy vija paralele janë prerë përgjatë skajit të pjesës së brezit të byzilykut. Brenda fushës së përcaktuar në këtë mënyrë janë gërvishtur dy vija të shkurtra të renditura në formë zigzage dhe e gjithë sipërfaqja e mbetur është zbukuruar me pika dhe zbukurime të stampuara.



47. Byzilyk

Hekur, farkëtim; dimensionet: diametri 4,4; trashësia e telit 0,2 cm; Katror: BIII /2.o.s; Muzeu i Polimles në Berane;

Datohet në gjysmën e dytë të shek. VI dhe fillimin e shek. VI

Një byzilyk i vogël hekuri, i bërë nga një rrip i ngushtë llamarine, me skaje të hapura që zgjerohen në formën e kokave të gjarprit. Koka është e theksuar me dy vija të gërvishtura paralele dhe sytë paraqiten në formë rrathësh me pikë..

	48. Unazë Hekur, farkëtim: diametri 2,1 trashësia e telit 0,1 cm; Katrori: CIV1 /1.o.s; Muzeu i Polimles në Berane; Datohet në shekullin VI dhe 1/3 e parë të shek. VII. Unazë hekuri me kokë në formë pllake ovale, e dëmtuar nga korrozioni, dekorim në kurorë i panjohur.
	49. Unazë Hekur, farkëtim: diametri 2 trashësia e telit 0,5 cm; Katrori: DIV1 /1.o.s; Muzeu i Polimles në Berane; Datohet në shekullin VI dhe 1/3 e parë të shek. VII. Unazë hekuri nga shirit i llamarinës së hekurit e cila zgjerohet në kokën në formë pllake me formë elipsoide.
	50. Kryq Hekur, farkëtim, prerje; dimensionet: 7,3 x 5,5 x 0,1 cm; hapësira ndërmjet bedenave, në perëndim të hyrjes së brendshme; katror: EIV /1.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane, Daton në shekullin VI Kryq hekuri, me cepa të zgjeruar, i punuar nga dy shirita llamarine, në mes të bashkuar me vidhë. Në pjesën e poshtme gjemba për fiksion.
	51. Kryq Bronz, farkëtim, prerje; dimensionet: 2,3 x 1,9 x 0,2 cm, Katror: CIII/1.o.s. Në kalimin në mes objektit rezidencial dhe bedenit të brendshëm. Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në gjysmën e dytë të shek. VI dhe fillimin e shek. VII Kryq i vogël i fragmentuar nga bronzi me cepa të zgjeruar dhe të shtrirë. Me gjasë është përdorur si varëse.

	52. Shtrydhëse Argjend, shkrirje, farkëtim, gërvishtje, punktim; dimensionet: 16,5 x 3,2 x 0,4 cm, muri lindor i objektit rezidencial, katror: EII /1.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në shekujt IV-VI S htrydhëse argjendi, me recipient gjysmërrethor, të performuar në formë radiale, nga qarku më i trashuar deri tek pjesa më e thellë. Në qark trashimi në formë katrori nga i cili fillon mbajtësja me prerje të rrumbullakos e përfundon me pllakën katrore nga e cila me punktim është krijuar vrima për varje. Në pjesën qendrore të mbajtëses është trashësia poligonale. E trashuar në formë katrori në fillim dhe fund të mbajtëses, e zbkuruar me nga dy vija të gërvishtura, paralele.
	53. Mortarium Gur, skalitje, lustrim; dimensionet: lartësia 14,4 ; gjerësia 20, trashësia 3,5 cm. Katror: Kvadrat: BII / Pov.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane Datohet në fund të shek.. VI dhe në fillim të shek.. VII Mortarium, i punuar nga guri ngjyrë okër të çelët, me granulim më të madh. Recipienti është me formë konike, i lustruar nga brenda, nga jashtë me sipërfaqe të vrazhda. Në nivelin e qarkut, nga jashtë, lyth me prerje gjysmërrethore.
	54. Monedhë bronzi Bronz, farkëtim; dimensionet: 2,9 x 0,3 cm; hapësira ndërmjet bedenave, në perëndim të hyrjes së brendshme. (Kv: EIV /2.o.s.); Muzeu i Polimles në Berane. Anastasije I (491-589)

	55. Monedhë bronzi Bronz, farkëtim; dimensionet: 2,9 x 0,3 cm; hapësira ndërmjet bedenave, në perëndim të hyrjes së brendshme. (Kv: EIV /2.o.s.); Muzeu i Polimles në Berane. Numus Justiniana I (527-565)
	56. Monedhë bronzi Bronz, farkëtim; dimensionet: 2,9 x 0,4 cm; hapësira ndërmjet bedenave, në perëndim të hyrjes së brendshme. (Kv: CIV/1.o.s.); Muzeu i Polimles në Berane. Folis Justiniana I (527-565)
	57. Monedhë bronzi Bronz, farkëtim; dimensionet: 3 x 0,3 cm; hapësira ndërmjet bedenave; CIV/1.o.s Folis Justinian I (527-565)
	58. Shigjetëz Hekur, farkëtim; dimensionet: 8,8 gjerësia e puplës 1,6 cm; hapësira ndërmjet bedenave; katror CII / 1.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane. Datohet në shek. VI dhe gjysmën e parë të shek. VI. Shigjetës e gjatë, prej hekuri, me tre tehe, me gjemb për fiksion.

	59. Gur (i peshores) Bronz, farkëtim, gërvishtje; dimensionet: 3,8 x 0,8 cm; Katror; GIII7 1.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane Datohet në shekullin VI dhe gjysmën e parë të shek. VII Gur (i peshores), me formë pllake rrethore, në pjesën e sipërme është gërvishtur kryqi, ndërsa poshtë shenja e peshës me dy shkronja qirilike “Г”. Shkronjat gjenden nga ana e djathtë dhe e majtë, poshtë vijave të kryqit.
	60. Gur (i peshores) Bronz, farkëtim, gërvishtje; dimensionet: 1,7 x 1,7 x 0,5 cm; Katror; GIII7 1.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane Datohet në shekullin VI dhe gjysmën e parë të shek. VII Gur (i peshores) i vogël, në formë katrori dhe prej bronzi. Në pjesën e sipërme në kurorën rrethore të shkronja qirilike “H i Г”, mbi të cilat është edhe shkronja “X”. Në shkronja vërehen gërvishtjet e thella, prandaj ekziston mundësia për matja e peshës me derdhen e plumbit ose të kallajit.
	61. Pjata e peshores Bronz, farkëtim, gërvishtje; dimensionet: 3,8 x 0,1 cm; Katror; EIII /Pov.o.s.;Muzeu i Polimles në Berane Datohet në shekullin VI dhe gjysmën e parë të shek. VII Pjatë për peshore me formë të rrumbullakët me çelje periferike për kapjen e zinxhirit.

BIBLIOGRAFIJA:

- Bace, A. (1976).** *Fortifications de la basse antiyute en Albanije*, Monumenti 11, 45-75.
- Basler, D. (1972).** *Arhitektura kasnoantičkog doba u Bosni i Hercegovini*, Sarajevo, 30-31.
- Bavant, B. (1999).** *Les petits objets*, in: Caričin grad II, Rim – Beograd, 191 – 257.
- Čović, B. (1978).** *Velika gradina u Varvari, I deo*, Glasnik zemaljskog muzeja XXXII, Sarajevo 1978, 46-54.
- Дерикоњић, С. (1996).** *Неолитске заједнице Полимља, Прибој*.
- Ђурић, Љ. (1996).** *The chipped stone industry from the rock-shelter of Trebački krš*, Prehistoric settlements in caves and rock-shelters of Serbia and Montenegro, Fascicule 1, The University of Belgrade – Faculty of Philosophy, Centre for Archeological Research, Volume 16, Belgrad.
- Фидановски, С. (1990).** *Римска керамика Улијане*. Универзитет у Београду – Филозофски факултет, Центар за археолошка истраживања, књига 10, Београд.
- Иванишевић, В. (2009).** *Nekropole iz epohe seobe naroda u Singidunumu*, Beograd.
- Kondić, V., Popović, V. (1977).** *Caričin Grad. Utvrđeno naselje u vizantijskom Iliriku*, Beograd.
- Kapuran, A. (2014).** *Praistorijski lokaleteti useveroistočnoj Srbiji*, Arheološki institut, Građa br. 10, Beograd.
- Ковачевић, Ј. (1967).** *Историја Црне Горе I*, Титоград, 241.
- Lutovac, P. (2008).** *Radmanska klisura – Torine*, Tokovi 1, Časopis za naučna, književna i društvena pitanja, Berane, 263-275.
- Lutovac, P. (2009).** *Bjelasica i Komovi – Nova arheološka istraživanja*, TOKOVI, br. 1, Časopis za naučna, književna i društvena pitanja, Berane, 245-256.
- Мијовић, П., Кобачевић, М. (1975).** *Градови и утврђења у Црној Гори*, Београд - Улцињ.
- Милинковић, М. (2010).** *Gradina na Jelici. Ranovizantijski grad i srednjovekovno naselje*. Beograd.
- Милинковић, М. (2017).** *Градина на Јелици – Рановизантијски утврђени центар у Илирику*, Београд – Чачак.
- Милинковић, М., Шпехар, П. (2014).** *Градина на Јелици – Тридесет година археолошких истраживања (1984-2014)*, Чачак.
- Милинковић, М. (1982).** *Касноантичко утврђење у Островици и Шароњима код Тутина*. Новопазарски Зборник 6, Нови Пазар.
- Милинковић, М. (1985).** *Рановизантијско утврђење на Тупом Кршу и околна утврђења у Тутинској области*, Новопазарски Зборник 9, Нови Пазар.
- Milovanović, M. - Filipović, O. (2018).** *Ranovizantijski period u okolini Žagubice – Pregled arheoloških nalaza*, Žagubica.
- Mirnik, I. A. (1981).** *Coin Hards in Yugoslavia*, BAR Inter. Ser. 95, Oxford, kat.br.195, 231, 149, 157.
- Mócsy, A. (1970).** *Gesellschaft und Romanisation in der Römischen Provinz Moesia superior*, Budapest, 194-198 sa komentarom izvora i epigrafske građe.
- Mirković, M. (1978).** *Antistes Stefanus i građevinska delatnost Justinijanovog vremena u Polimlju*, Zbornik Vizantološkog instituta XVIII, Beograd, 1-8.
- Мркобрад, Д. (1980).** *Археолошки налази сеобе народа у Југославији*. Београд.
- Мркобрад, Д., Јовановић, А. (1989).** *Самоград – Археолошка истраживања*, Новопазарски Зборник 13, Нови Пазар.
- Николајевић, И. (1986).** *Сеоски дани С. Вукослављевића 3*, Пријеполје.
- Поповић, Љ. (198).** *Хеленистички рељефни пехари из грчке збирке Народног музеја*, Зборник Народног музеја ЦИИ-1, археологија, Београд.
- Поповић, М. (1983).** *Античко утврђење на Шарском Кршу код Дуге Пољане*, Новопазарски Зборник 9, Нови Пазар.
- Поповић, М. (1987).** *Светиња, нови подаци о рановизантијском Виминацијуму*. Старица XXXVIII, Београд.
- Петковић, С. (1995).** *Римски предмети од кости и рога са територије Горње Мезије*, Београд.
- Поповић, М. (1999).** *Тврђава Рас*, Београд.
- Поповић, М., Бикић, В. (2009).** *Велеснице – Касноантичко и српско раносредњовековно утврђење*, Београд.
- Поповић, В. (1988).** *Албанија у касној антици*, САНУ – Одељење историјских наука, Књига 10, Београд.
- Prendi, F., Bunguru, A. (2008).** *The Earli bronze age in Albania*, The Albanological Studying center the Institute of archeology, Priština 2008.
- Radić, V., Ivanišević, V. (2013).** *Vizantijski novac iz Narodnog muzeja u Beogradu*, Beograd.
- Stojić, M. (1977).** *Kulturni objekat na lokalitetu Panjevački rit u Jagodini*. Uzdarje Dragoslavu Srejo-вићу, Centar za arheološka istraživanja Fukizogskog fakulteta, Univerziteta u Beogradu, Beograd.
- Tasić, N. (1977).** *Neki problemi hronologije i geneze Brnjica kulture*. Uzdarje Dragoslavu Srejo-вићу, Centar za arheološka istraživanja Fukizogskog fakulteta, Univerziteta u Beogradu, Beograd.
- Шпехар, П. (2019).** *Материјална култура из рановизантијских утврђења на Ђердапу*. Београд.
- Шпехар, П. (2019).** *Опрема за осветљавање током рановизантијског периода на простору сјеверног Илирика*. Зборник радова Народног музеја, Београд, 317-346.
- Вешовић, Ј. Р. (1935).** *Племе Васојевићи*, Сарајево.
- Живић, Т. (2003).** *Felix Romulijana: 50 година одгонетанја*, Зајечар 2003.